

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË**  
**Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve**

**SKELETKURRIKULI**

**Për Drejtimin Mësimor**

**“BUJQËSI”**

**Niveli IV i KSHK**  
**(1 vjeçar)**

**Kodi: H-IV-21**

Miratoi:

**MINISTRI**

**Tiranë, 2021**

## **Përmbajtja:**

- I. Qëllimet e arsimit profesional në drejtimin “Bujqësi”, niveli IV i Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK) , 1 vjeçar.**
- II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Bujqësi”, niveli IV i KSHK.**
  1. Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional në drejtimin “Bujqësi”, niveli IV i KSHK.
  2. Kompetencat e përgjithshme të nxënësve në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Bujqësi”, niveli IV i KSHK.
  3. Kompetencat profesionale të nxënësve në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Bujqësi”, niveli IV i KSHK.
  4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtejshëm në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Bujqësi”, niveli IV i KSHK.
- III. Plani mësimor për drejtimin “Bujqësi”, niveli IV i KSHK.**
- IV. Udhëzime për planin mësimor.**
- V. Udhëzime për procesin mësimor.**
- VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet.**
- VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Bujqësi”, niveli IV i KSHK.**
- VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale.**
- IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale të detyruar.**

## **I. Qëllimet e arsimit profesional në drejtimin “Bujqësi”, niveli IV i KSHK.**

Qëllimi kryesor i arsimit profesional në drejtimin “Bujqësi”, niveli IV i KSHK, është *“zhvillimi i personalitetit të nxënësve për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon dhe përgatitja e tyre për t’u punësuar në veprimtaritë profesionale që lidhen drejtpërdrejt me prodhimin bujqësor dhe blegtoral, si dhe për të vijuar arsimimin dhe formimin në nivele më të larta”*. Për të realizuar këtë, shkolla profesionale u krijon nxënësve:

- mundësi të përshtatshme për të nxënë, pavarësisht nga gjinia, raca, besimi dhe aftësitë;
- mundësi për të gjithë, për të zhvilluar kompetencat profesionale, të bazuara në njohuritë, shprehitë, qëndrimet dhe vlerat, të mjaftueshme për të lehtësuar punësimin dhe përparimin drejt formimit profesional dhe arsimit të mëtejshëm;
- mbështetje për t’u njohur me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm, me rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe për t’i zbatuar ato me rreptësi;
- mbështetje për t’u njohur me teknologjitë e proceset teknologjike bashkëkohore e të perspektivës, që lidhen me kualifikimin profesional përkatës;
- mbështetje për të zhvilluar ndjenjën e disiplinës dhe përgjegjësisë, kuriozitetin intelektual dhe profesional, aftësitë sipërmarrëse dhe menaxhuese, si dhe vlerat morale;
- mbështetje për t’u zhvilluar psikologjikisht dhe fizikisht, për të përballuar vështirësitë që do të ndeshin gjatë veprimtarive të ardhshme profesionale dhe akademike;
- mbështetje për të zhvilluar frymën e tolerancës dhe të mirëbesimit nëpërmjet përvojës së punës.

## **II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Bujqësi”, niveli IV i KSHK.**

### **1. Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional në drejtimin “Bujqësi”, niveli IV i KSHK.**

Në shkollat që ofrojnë arsimin profesional në drejtimin “Bujqësi”, niveli IV i KSHK kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë të rinjtë që:

- kanë mbaruar arsimin profesional në një nga profilet e nivelit III të KSHK të drejtimit mësimor “Bujqësi”;
- janë të aftë fizikisht dhe mendërisht të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional.
- kanë aftësi të kufizuara, por për të cilët shkolla krijon kushte dhe përshtat programin në përputhje me paaftësitë që shfaqin.

Në raste të veçanta kur kërkesat për të ndjekur këtë shkollim janë më të larta se kapacitetet reale të këtyre shkollave, atëherë, MFE përgatit udhëzime të veçanta me kritere të posaçme pranimi për këto shkolla.

### **2. Kompetencat e përgjithshme të nxënësve në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Bujqësi”, niveli IV i KSHK.**

Në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Bujqësi”, niveli IV i KSHK, nxënësi do të zotërojë këto kompetenca të përgjithshme kryesore:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme.

- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të grumbullimit dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional.
- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive.
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror.
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale dhe ndërkombëtare.
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse e menaxhuese për të ardhmen e tij.
- Të tregojë vetëkontroll dhe përshtatshmëri gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij.
- Të organizojë drejt procesin e të nxënësve të tij dhe të shfaqë gadishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës.
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar.
- Të vlerësojë dhe vetvlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij.

### **3. Kompetencat profesionale të nxënësve në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Bujqësi”, niveli IV i KSHK.**

Në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Bujqësi”, niveli IV i KSHK, nxënësi do të jetë i aftë të zhvillojë më tej kompetencat profesionale të fituara në njërin nga profilet mësimore të nivelit III të KSHK, si dhe të ushtrojë kompetenca të tjera profesionale, si më poshtë:

- Të hartojë një plan-bisnesi që lidhet me veprimtaritë profesionale të një biznesi të vogël bujqësor.
- Të kryejë llogaritje ekonomike që lidhen me veprimtaritë profesionale të një biznesi të vogël bujqësor.
- Të menaxhojë burimet njerëzore, materiale dhe financiare gjatë veprimtarive profesionale të një biznesi të vogël bujqësor.
- Të interpretojë, plotësojë dhe përgatisë dokumentacion që lidhen me veprimtaritë profesionale të një biznesi të vogël bujqësor.
- Të zbatojë bazën ligjore që i referohet veprimtarive profesionale bujqësore.
- Të zbatojë parimet e etikës gjatë ushtrimit të veprimtarive profesionale bujqësore.
- Të zbatojë standardet teknike në fushën e prodhimit bujqësor dhe blegtoral.
- Të zbatojë procedurën për hapjen e një biznesi bujqësor.
- Të blejë mallra e shërbime për fermën bujqësore.
- Të shesë mallra/produkte e shërbime të fermës bujqësore.
- Të zhvillojë marketingun e produkteve bujqësore e blegtorale dhe nënprodukteve të tyre.
- Të përdorë teknologjinë e informimit dhe komunikimit në fushën e prodhimit bujqësor dhe blegtoral.
- Të ndjekë ruajtjen e pjellorisë së tokës për mosdegradimin e saj.
- Të ndjekë prodhimin bujqësor të bimëve të arave, drurëve frutorë, perimeve etj.
- Të vlerësojë tokën bujqësore për prodhim BIO.
- Të prodhojë produkte organike në fermën bujqësore.
- Të ndjekë luftën e integruar të sëmundjeve dhe dëmtesve në kulturat bujqësore.
- Të simulojë krijimin e një kooperative bujqësore në rajon.

- Të zbatojë rregullat e sigurisë në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë kryerjes së veprimtarive bujqësore.
- Të komunikojë me etikë profesionale.

#### 4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtejshëm në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Bujqësi”, niveli IV i KSHK.

Përfundimi me sukses i arsimit profesional në drejtimin “Bujqësi”, niveli IV i KSHK, e pajis nxënësin me Diplomën e Maturës Shtetërore Profesionale, si dhe me Certifikatën e teknikut/menaxherit të ekonomive bujqësore. Ky kualifikim i jep nxënësit mundësinë që t’i drejtohet tregut të punës për punësim në sektorin e bujqësisë. Gjithashtu, nxënësi mund të vetëpunësohet në kuadrin e një biznesi individual në fushën e bujqësisë. Me përfundimin e këtij niveli, nxënësi ka mundësi për vazhdimin e arsimit profesional në nivelin pas të mesëm ose në nivelin e studimeve universitare.

### III. Plani mësimor për drejtimin “Bujqësi”, niveli IV i KSHK (1 vjeçar).

<b>Plani mësimor për drejtimin “Bujqësi”, niveli IV i KSHK.</b>			
<b>Nr</b>	<b>Kodi</b>	<b>Lëndët dhe modulet mësimore</b>	<b>Orët</b>
			<b>javore/ vjetore</b>
			<b>Klasa 13</b>
<b>A.</b>		<b>Lëndët e përgjithshme</b> (Gjithsej)	<b>15/16</b> (480/512)
1		Gjuhë shqipe	1
2		Letërsi	1
3		Gjuhë e huaj e parë	2
4		Gjuhë e huaj e dytë (me zgjedhje të lirë)	(1)
5		Matematikë	2
6		Fizikë	1
7		Biologji	2
8		Shkenca sociale	1
9		Histori	1
10		Gjeografi	1
11		TIK	1
12		Edukim fizik, sporte, shëndet	2
<b>B.</b>		<b>Lëndët profesionale</b> (Gjithsej)	<b>9</b> (288)
1	L-17-197-20	Bazat e sipërmarrjes	2
2	L-05-198-12	Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm	1
3	L-17-557-21	Drejtimi, ligjshmëria dhe ekonomia në bujqësi	3
4	L-14-284-12	Përmirësimi uJOR dhe sistemimi i tokave	1
5	L-14-285-12	Bazat e bujqësisë organike	2
<b>C.</b>		<b>Module të detyruar të praktikës profesionale</b> (Gjithsej)	<b>6</b> (192)
1	M-17-841-21	Hapja e një biznesi bujqësor	30
2	M-14-842-21	Vlerësimi i tokës për prodhim BIO	33

3	M-14-1718-21	Prodhimi i produkteve organike në fermën bujqësore	36
4	M-14-844-21	Zbatimi i planit të masave të mbrojtjes së integruar në bujqësi	33
5	M-17-1719-21	Blerja dhe shitja e mallrave e shërbimeve bujqësore	60
		<b>Gjithsej A+B+C</b>	<b>30/31</b> (960/ 992)

#### IV. Udhëzime për planin mësimor

Në klasën 13, viti shkollor ka gjithsej 36 javë (32 javë mësimore + 4 javë provime).

Një javë mësimore ka jo më shumë se 31 orë mësimore (teorike dhe praktike).

Një orë mësimore zgjat 45 minuta.

Kurrikuli i arsimit profesional në drejtimin “Bujqësi”, niveli IV i KSHK, përbëhet nga 3 grupe elementesh kurrikulare:

- Lëndët e kulturës së përgjithshme, të përbashkëta për drejtimet e ndryshme të këtij niveli (programet e detajuara të tyre jepen në një dokument të veçantë të MASR).
- Lëndët e kulturës profesionale (programet e përgjithshme janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).
- Modulet e praktikave profesionale të detyruara (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).

Rekomandohet që modulet e praktikës profesionale të realizohen në ndarje ditore 3 orëshe ose 6 orëshe.

#### V. Udhëzime për procesin mësimor

Mësuesit e lëndëve teorike profesionale dhe instruktorët e moduleve të praktikave profesionale duhet të përzgjedhin dhe përdorin forma dhe metoda mësimdhënieje të tilla që të nxisin maksimalisht të nxënit aktiv të nxënësve dhe të çojnë në krijimin e ta, të kompetencave profesionale dhe menaxheriale, të plota dhe të qëndrueshme.

E rëndësishme është që *planifikimi i mësimdhënies* të bazohet në një proces analize fillestare, i cili të marrë parasysh faktorë të tillë të rëndësishëm si, niveli i përgatitjes së nxënësve në hyrje, përmbajtja e hollësishme e lëndëve profesionale dhe e moduleve të praktikave profesionale të parashikuara dhe shkalla e integritit të tyre, objektivat konkretë që do të arrihen, mundësitë reale që ka shkolla për realizimin e veprimtarive mësimore etj. Për këtë planifikim duhet një bashkëpunim i ngushtë i të gjithë personelit mësimdhënës dhe drejtues të shkollës.

Elementi kyç për arritjen e suksesit në një proces të nxëni, është *motivimi i nxënësve*. Njohja e vazhdueshme e nxënësve me shkallën e përmbushjes së objektivave nga ana e tyre përbën një mekanizëm të fuqishëm motivimi, i cili duhet të shihet me përparësi nga mësuesit.

Një element tjetër që ndihmon suksesin është *integrimi i teorisë me praktikën* e profesionit. Parimi i “të nxënit duke bërë” duhet të gjejë vendin e duhur në procesin e të mësuarit në shkollat profesionale të drejtimit mësimor “Bujqësi”, niveli IV i KSHK.

Mësuesit dhe instruktorët duhet të përdorin metoda të tilla të të mësuarit që zhvillojnë jo vetëm njohuritë teorike, shkathtësitë dhe shprehitë praktike të nxënësve, por edhe qëndrimet e tyre ndaj jetës, punës dhe shoqërisë në përgjithësi. *Puna në grup* dhe *Puna me projekte* janë dy nga format bazë të organizimit të mësimit (teorik ose praktik) për të zhvilluar kompetencat kyçe, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve që kanë të bëjnë me veprimtarinë profesionale

në veçanti dhe jetën e profesionistit të ardhshëm, në përgjithësi. Rekomandohet përdorimi i metodës së “*lojës me role*”, ku nxënësve tu jepen përgjegjësi në kryerjen e funksioneve menaxhuese dhe drejtuese.

Një parim tjetër që duhet respektuar nga mësuesit dhe instruktorët është fakti që *të nxënit nuk ndodh vetëm në mjediset e shkollës, por edhe jashtë tyre*. Dhënia e detyrave dhe puna kërkimore e pavarur e nxënësve ka një ndikim të dukshëm në formimin e tyre si profesionistë të ardhshëm të drejtimit profesional “Bujqësi”.

Në rastin e nxënësve me aftësi të kufizuara, mësuesit duhet të përshtasin programet e lëndëve dhe përshkruesit e moduleve në përputhje me mundësitë e tyre, si dhe të krijojnë kushte për zbatimin e tyre.

## **VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet përfundimtare.**

Vlerësimi vjetor i nxënësve në lëndët teorike profesionale dhe modulet e praktikave profesionale bëhet nga vetë mësuesit dhe instruktorët përkatës, me metoda dhe instrumente vlerësimi të përgatitura ose përzgjedhura nga vetë ata. Vlerësimi i nxënësve të bëhet me nota (4-10) si për lëndët teorike, ashtu edhe për modulet praktike, si gjatë vitit, ashtu edhe në provimet përfundimtare.

Në përfundim të klasës së 13-të, nxënësi i arsimuar në drejtimin mësimor “Bujqësi”, niveli IV i KSHK, i nënshtrohet provimeve të Maturës Shtetërore Profesionale (sipas udhëzimeve të MASR dhe MFE) si dhe Provimit të Praktikës Profesionale të Integruar (sipas udhëzimeve të MFE).

## **VII. Të dhëna për çertifikatën që fitohet në përfundim të arsimit profesional në drejtimin mësimor “Bujqësi”, niveli IV i KSHK.**

Me përfundimin e suksesshëm të arsimit profesional në drejtimin mësimor “Bujqësi”, niveli IV i KSHK, shkolla profesionale e pajis nxënësin me Diplomën e Maturës Shtetërore Profesionale, si dhe me si dhe me Çertifikatën e teknikut/menaxherit të ekonomive bujqësore, të cilat njihen në territorin e Republikës së Shqipërisë. Sipas modeleve të miratuara nga MFE, këto dëshmi përmbajnë:

a) Të dhënat për nxënësin, shkollën, vitin e përfundimit, kualifikimin e fituar, etj.

b) Të dhëna për rezultatet e arritura nga nxënësi:

- rezultatet në lëndët e përgjithshme, lëndët profesionale dhe modulet profesionale të klasës 13-të;

- rezultatet e provimeve të Maturës Shtetërore Profesionale dhe të Praktikës Profesionale të Integruar.

## VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale.

### 1. Lënda “Bazat e sipërmarrjes” (L-17-157-20) Kl. 13 – 64 orë

- Synimet e lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl. 13.

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl.13, nxënësit duhet:

- të analizojnë veçoritë e etikës dhe komunikimit në kontekstin e veprimtarisë së bizneseve
- të bëjnë vlerësimin e mundësive dhe rreziqeve në kontekstin e konceptimit të idesë së biznesit
- të përshkruajnë rëndësinë dhe strukturën e një plani biznesi
- të zbatojnë procedurat e regjistrimit dhe përshkruajnë fazat e zhvillimit të biznesit
- të konceptojnë strukturën organizative dhe përshkrimet e punës së personelit të një biznesi
- të përshkruajnë veçoritë e planifikimit, rekrutimit, seleksionimit dhe zhvillimit të burimeve njerëzore të një biznesi
- të analizojnë aspektet e buxhetimit të një biznesi
- të kryejnë llogaritje ekonomike në kuadrin e kontabilitetit financiar të një biznesi
- të llogarisin kostot dhe çmimet e produkteve e shërbimeve të një biznesi
- të analizojnë aspektet e marketingut dhe teknikat e shitjeve në një biznes
- të analizojnë rolin dhe teknikat e e-sipërmarrjes në veprimtarinë e bizneseve.
- të përshkruajnë dhe simulojnë veprimet individuale me bankat, në lidhje me llogaritë, transfertat, kreditë dhe investimet.
- të analizojnë llojet e siguracioneve personale dhe veprimet që kryhen me to.

- Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl.13 - 64 orë

<b>Tema 1</b>	Etika dhe komunikimi në biznes	4 orë
<b>Tema 2</b>	Konceptimi i idesë së biznesit, vlerësimi i mundësive dhe rreziqeve	6 orë
<b>Tema 3</b>	Hartimi i planit të biznesit	6 orë
<b>Tema 4</b>	Procedurat e regjistrimit të biznesit	6 orë
<b>Tema 5</b>	Struktura organizative dhe personeli i biznesit	5 orë
<b>Tema 6</b>	Planifikimi, rekrutimi, seleksionimi dhe zhvillimi i burimeve njerëzore	6 orë
<b>Tema 7</b>	Kostimi dhe çmimi i produkteve dhe shërbimeve	4 orë
<b>Tema 8</b>	Kontabiliteti financiar në kuadrin e biznesit	6 orë
<b>Tema 9</b>	Buxhetimi në biznes	4 orë
<b>Tema 10</b>	Marketingu dhe shitjet në biznes	9 orë
<b>Tema 11</b>	E – sipërmarrja	2 orë
<b>Tema 12</b>	Veprimet individuale me bankat	3 orë
<b>Tema 13</b>	Siguracionet personale	3 orë



## 2. Lënda “Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm” (L-05-198-12). Kl.13 – 32 orë

### • Synimet e lëndës “Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm”, kl. 13.

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm”, kl.13, nxënësit duhet:

- Të shpjegojnë kuptimin për “mjedisin” dhe “mbrojtjen e mjedisit”.
- Të shpjegojnë kuptimin për “zhvillimin e qëndrueshëm”
- Të tregojnë se si ndikon veprimtaria e njeriut në mjedisin rrethues.
- Të përshkruajnë burimet kryesore të mjedisit jetësor.
- Të analizojnë marrëdhëniet midis zhvillimeve demografike dhe mjedisit jetësor.
- Të tregojë dhe japin shembuj të ndikimit të mbetjeve në mjedisin jetësor
- Të përshkruajnë mekanizmat e monitorimit të burimeve mjedisore.
- Të përshkruajnë kuadrin ligjor dhe institucional ndërkombëtar, kombëtar dhe vendor në lidhje me mjedisin dhe zhvillimin e qëndrueshëm
- Të përshkruajnë sistemet e menaxhimit të mjedisit.
- Të hulumtojnë dhe analizojnë problemet mjedisore në mjedisin vendor.
- Të planifikojnë dhe realizojnë veprimtari praktike për mbrojtjen e mjedisit vendor.

### • Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm”, kl.13 - 32 orë

<b>Tema 1</b>	Njohuri të përgjithshme për mjedisin dhe zhvillimin e qëndrueshëm	2 orë
<b>Tema 2</b>	Burimet kryesore të mjedisit dhe degradimi mjedisor	3 orë
<b>Tema 3</b>	Ndikimi i veprimtarisë së njeriut në mjedis	3 orë
<b>Tema 4</b>	Zhvillimet demografike dhe mjedisi	4 orë
<b>Tema 5</b>	Shoqëria e konsumit dhe mbetjet	4 orë
<b>Tema 6</b>	Monitorimi i burimeve mjedisore	4 orë
<b>Tema 7</b>	Kuadri ligjor dhe institucional për mjedisin dhe zhvillimin e qëndrueshëm	2 orë
<b>Tema 8</b>	Sistemet e menaxhimit të mjedisit	3 orë
<b>Tema 9</b>	<u>Veprimtari praktike</u> për analizën e problemeve dhe planifikimin e nismave mjedisore në nivel lokal	3 orë
<b>Tema 10</b>	<u>Veprimtari praktike</u> për mbrojtjen e mjedisit lokal	4 orë

## 3. Lënda “Drejtimi, ligjshmëria dhe ekonomia në bujqësi”(L-17-557-21) Kl.13-96 orë

### • Synimet e lëndës “Drejtimi, ligjshmëria dhe ekonomia në bujqësi”, kl. 13

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Drejtimi, ligjshmëria dhe ekonomia në bujqësi”, kl 13, nxënësi duhet:

- Të përshkruajë aspektet kryesore të drejtimit të fermave bujqësore.
- Të përshkruajë karrierat e punësimeve në fermat bujqësore.
- Të përshkruajë parimet e teorisë ekonomike të fermës bujqësore.
- Të përcaktojë objektivat afatshkurtra dhe afatmesme të fermës.
- Të përshkruajë domosdoshmërinë dhe parimet e drejtimit të fermave bujqësore.

- Të përshkruajë procesin e marrjes së vendimeve, funksionet dhe fushat e drejtimit të fermës bujqësore.
- Të përshkruajë marrëdhëniet e prodhimit, llojet e produktit, marrëdhëniet e kostove dhe ligjin e fitimeve në rënie, si dhe zgjedhjen e nivelit të përdorimit të faktorëve prodhues me të gjitha llojet e alternativat.
- Të përshkruajë domosdoshmërinë dhe strukturën e buxhetit të një aktiviteti bujqësor.
- Të përshkruajë procedurat e planifikimit të përgjithshëm të fermës, pjesët përbërëse të buxhetit dhe buxhetin e lëvizjes së parave.
- Të përshkruajë llojet e riskut dhe qëndrimet e fermerit ndaj tyre.
- Të theksojë përshkrimet e punës të personelit në fermat bujqësore.
- Të përshkruajë ndarjen e detyrave dhe organizimine punës në fermat bujqësore.
- Të përshkruajë marrëdhëniet juridike të të punësuarve në fermat bujqësore.
- Të përshkruajë parimet, burimet, sistemet dhe subjektet e së drejtës.
- Të përshkruajë kuptimin e së drejtës agrare, raportin e saj me degët e tjera të së drejtës.
- Të përshkruajë kuptimin e pronës dhe elementët e së drejtës së pronësisë.
- Të përshkruajë mënyrat e bashkëpronësisë dhe shpronësimit.
- Të përshkruajë kuptimin e uzufruktit dhe servitutit.
- Të përshkruajë kuptimin e kontratës dhe llojet e kontratave.
- Të përshkruajë qiranë e tokës bujqësore, livadheve dhe kullotave.
- Të përshkruajë mënyrat e shfrytëzimit të pyjeve, fondin pyjor, si dhe regjimin juridik të ujërave.
- Të përshkruajë kuptimin, rëndësinë dhe praktikën e marketingut dhe planifikimin e tij.
- Të rendisë burimet e sigurimit të kapitalit në fermë dhe faktorët që ndikojnë në marrjen dhe dhënien e kredisë në bujqësi.
- Të përshkruajë rëndësinë dhe faktorët që ndikojnë në sigurimin dhe drejtimin e krahut të punës në fermat bujqësore.
- Të analizojë investimet kapitale në bujqësi.
- Të paraqesë format e ndryshme të administrimit të tokës: blerja e tokës, qeraja etj.
- Të përshkruajë fragmentizimin dhe treguesit që masin nivelin e fragmentizimit në fermë.
- Të përshkruajë burimet e sigurimit të makinave, pajisjeve dhe sistemeve bujqësore: blerja dhe marrja me qera, si dhe mënyrën e llogaritjes së kostove të përdorimit dhe mirëmbajtjes së tyre.
- Të pasqyrojë lidhjet e madhësisë së fermës me kostot.
- Të shpjegojë doemosdoshmërinë e rritjes së fermës në varësi të kushteve dhe burimeve financiare.
- Të përshkruajë objektin e veprimtarisë së kontabilitetit, detyrat, qëllimet dhe parimet e tij.
- Të dallojë konceptet: “pasuri”, “detyrim” dhe “kapital” të ndërmarrjes bujqësore.
- Të krahasojë konceptin e bilancit me atë të inventarit.
- Të zbërthejë bilancin në llogari aktive dhe pasive.
- Të zbatojë metodën e rregjistrimit të dyfishtë në rregjistrimin e veprimeve ekonomike.
- Të kryejë rregjistrimet në llogaritë e të ardhurave dhe shpenzimeve.
- Të rregjistrojë në llogaritë përkatëse shitjet dhe blerjet e kryera.
- Të përshkruajë nocionin e vlerës së shtuar dhe përbërjen e saj.
- Të rregjistrojë në kontabilitet shlyrjen e detyrimit ndaj shtetit për t.v.sh.
- Të kryejë rregjistrimet kontabël të shpenzimeve të lindura gjatë shitjes dhe blerjes si dhe lëvizjen e ambalazheve.
- Të llogarisë uljen e vlerës së aktiveve të qëndrueshme me metoda të ndryshme.
- Të përshkruajë procedurën e mbylljes së llogarisë private.

- Të përshkruajë rregjistrimet kontabël në fushën e personelit dhe qarkullimin e pagesave.
- Të përshkruajë procedurën e plotë që çon në hartimin e bilancit përfundimtar.
- Të përshkruajë domosdoshmërinë e analizës dhe vlerësimit të mbylljes vjetore.
- Të tregojë ku konsiston analiza e bilancit.
- Të përshkruajë rregullat e etikës profesionale dhe të komunikimit në fermat bujqësore.
- Të përshkruajë konceptin , qëllimin, përparësitë dhe historikun e kooperativizmit në bujqësi.
- Të përshkruajë procesin e krijimit të ndërmarrjes bujqësore në modelin e kooperativës: format kryesore dhe karakteristikat kooperativave bujqësore me anë të shenbujve.
- Të përshkruajë organogramën e një kooperative bujqësore, burimet e nevojshme për krijimin e kooperativës bujqësore, si dhe kërkesat ligjore dhe kontraktuale për krijimin dhe funksionimin e kooperativës bujqësore.
- Të hartojë dhe prezantojë një projekt për simulimin e krijimit të një kooperative bujqësore sipas fazave:
  - mbledhja e të dhënave pën tregut bujqësor në rajonin ku bën pjesë shkolla profesionale.
  - analiza e të dhënave dhe përcaktimi i formës së kooperativës që do të krijohet
  - ndërtimi i organogramës së kooperativës bujqësore të simuluar
  - përcaktimi i burimeve të nevojshme për krijimin e kooperativës

• **Përmbajtja e përgjithshme e lëndës “Drejtimi, ligjshmëria dhe ekonomia në bujqësi”, kl.13 – 96 orë**

<b>Tema 1</b>	Aspekte kryesore të drejtimit të fermave bujqësore	2 orë
<b>Tema 2</b>	Karrierat e punësimeve në fermat bujqësore	2 orë
<b>Tema 3</b>	Parimet ekonomike të drejtimit të fermave bujqësore	3 orë
<b>Tema 4</b>	Teknikat e buxhetimit dhe të planifikimit bujqësor	3 orë
<b>Tema 5</b>	Drejtimi i fermës dhe kushtet e riskut dhe pasigurisë	3 orë
<b>Tema 6</b>	Përshkrimet e punës të personelit në fermat bujqësore	3 orë
<b>Tema 7</b>	Ndarja e detyrave dhe organizimi i vogël i punës në fermat bujqësore	3 orë
<b>Tema 8</b>	Marrëdhëniet juridike të të punësuarve në fermat bujqësore	2 orë
<b>Tema 9</b>	Parimet, burimet, sistemet dhe subjektet e së drejtës	3 orë
<b>Tema 10</b>	Kuptimi i së drejtës agrare, raporti i saj me degët e tjera të së drejtës	3 orë
<b>Tema 11</b>	Prona dhe elementët e së drejtës së pronësisë	2 orë
<b>Tema 12</b>	Bashkëpronësia dhe shpronësimi	3 orë
<b>Tema 13</b>	Kontratat, veçoritë e kontratave në sektorin bujqësor	4 orë
<b>Tema 14</b>	Marketingu bujqësor	3 orë
<b>Tema 15</b>	Sigurimi i kapitalit dhe kredisë në bujqësi	3 orë
<b>Tema 16</b>	Sigurimi dhe përdorimi i tokës.	4 orë
<b>Tema 17</b>	Sigurimi dhe drejtimi i krahut të punës	3 orë
<b>Tema 18</b>	Sigurimi dhe përdorimi i makinerive bujqësore	3 orë
<b>Tema 19</b>	Madhësia e fermës dhe rritja e saj	2 orë
<b>Tema 20</b>	Detyrat e kontabilitetit, inventarizimi dhe bilanci në bujqësi	4 orë
<b>Tema 21</b>	Pasqyrimi kronologjik i veprimeve ekonomike bujqësore	3 orë
<b>Tema 22</b>	Llogaritë e rezultatit dhe llogaritë e mallrave	5 orë
<b>Tema 23</b>	Tatimi mbi vlerën e shtuar	3 orë
<b>Tema 24</b>	Regjistrimet për blerjet dhe shitjet	3 orë
<b>Tema 25</b>	Aktivitetet e qëndrueshme dhe regjistrimet që lidhen me to	3 orë

<b>Tema 26</b>	Lista e llogarive, plani kontabël dhe llogaritë private	3 orë
<b>Tema 27</b>	Rregjistrimet kontabël në fushën e personelit dhe qarkullimi i pagesave	3 orë
<b>Tema 28</b>	Mbyllja vjetore dhe analiza e bilancit	3 orë
<b>Tema 29</b>	Rregulla të etikës profesionale dhe të komunikimit në fermen bujqësore	2 orë
<b>Tema 30</b>	Koncepti, qëllimi dhe përparësitë e kooperimit në bujqësi	1 orë
<b>Tema 31</b>	Format, organizimi, burimet, kërkesat ligjore të kooperativave bujqësore	3 orë
<b>Tema 32</b>	<u>Projekt</u> : Simulimi i fazave të krijimit të një kooperative bujqësore në rajon	6 orë

#### 4. Lënda “Përmirësimi ujqor dhe sistemimi i tokave” (L-14-284-12). Kl. 13 – 32 orë

- Synimet e lëndës “Përmirësimi ujqor dhe sistemimi i tokave”, kl. 13.

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Përmirësimi ujqor dhe sistemimi i tokave”, kl.13, nxënësit duhet:

- Të përshkruajnë rëndësinë dhe faktorët që ndikojnë në ujitje.
- Të tregojnë format e ujit në tokë dhe marrëdhëniet tokë-ujë-bimë.
- Të përshkruajnë elementet bazë të përcaktimit të nevojave të bimës për ujë.
- Të përshkruajnë dukurinë e infiltrimit, si dhe marrëdhëniet midis ritmit të infiltrimit dhe furnizimit të tokës me ujë.
- Të përshkruajnë ç’është evapotraspirimi dhe faktorët që ndikojnë në të.
- Të llogarisin normën agronomike të ujitjes.
- Të theksojnë cilat janë treguesit më të rëndësishëm që përcaktojnë cilësinë e ujit.
- Të rendisin mënyrat e ndryshme të ujitjes së bimëve.
- Të përshkruajnë faktorët që përcaktojnë nevojat për kullim.
- Të përshkruajnë ujrat nëntokësore dhe rëndësinë e njohjes së tyre.
- Të theksojnë detyrën e rrjetit kullues.
- Të llogarisin prurjen që largon rrjeti kullues nga toka bujqësore.
- Të bëjnë skemën e rrjetit të kanale kulluese për një sipërfaqe toke të dhënë.
- Të përshkruajnë rolin e drenazhimit në kullimin e tokave.
- Të rendisin llojet e drenave.
- Të përshkruajnë zbatimin praktik të drenazhimit të tokave bujqësore.
- Të përshkruajnë hartat dhe planet topografike, si dhe mënyrat e orientimit të hartave.
- Të rendisin faktorët që ndikojnë në gërryerjen e tokës.
- Të përshkruajnë rëndësinë e sistemimit të tokës dhe rolin e raportit ujë-ajër-tokë.
- Të analizojnë llojet e sistemimit sipërfaqësor.
- Të bëjnë dallimin midis sistemimit kurriz dhe rrafsh të tokës.
- Të përshkruajnë rolin e sistemimit ekstensiv të tokave të pjerrta.
- Të rendisin format e sistemimit ekstensiv.
- Të përshkruajnë rolin që kanë brezaret në tokat e pjerrëta.
- Të analizojnë elementet përbërës të brezares.
- Të përshkruajnë sistemet e kullimit dhe ujitjes së brezareve.
- Të përshkruajnë mënyrat e piktimit dhe teknikat e ndërtimit të brezareve.

- Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Përmirësimi uJOR dhe sistemimi i tokave”, kl.13 - 32 orë

	<i>Për ujitjen e tokave bujqësore</i>	
<b>Tema 1</b>	Faktorët që ndikojnë në përmirësimin uJOR dhe marrëdhëniet tokë-ujë-bimë	3 orë
<b>Tema 2</b>	Nevojat e bimës për ujë dhe evapotranspirimi	2 orë
<b>Tema 3</b>	Norma agronomike e ujitjes dhe cilësia e ujit për ujitje	2 orë
<b>Tema 4</b>	Mënyrat e ujitjes	5 orë
	<i>Për kullimin e tokave bujqësore</i>	
<b>Tema 5</b>	Nevojat për kullim, filtrimi dhe matja e nivelit të ujit nëntokësor	3 orë
<b>Tema 6</b>	Rrjetet kulluese dhe drenazhimi	5 orë
	<i>Për sistemimin e tokave bujqësore</i>	
<b>Tema 7</b>	Njohuri për hartat dhe planet topografike	2 orë
<b>Tema 8</b>	Gërryerja e tokës nga uji dhe era dhe faktorët ndikues të saj	2 orë
<b>Tema 9</b>	Sistemimi sipërfaqësor kurriz dhe rrafsh i tokave bujqësore	4 orë
<b>Tema 10</b>	Sistemimi ekstensiv dhe intensiv i tokave të pjerrëta	4 orë

## 5. Lënda “Bazat e bujqësisë organike” (L-14-285-12). Kl. 13 – 64 orë

- Synimet e lëndës “Bazat e bujqësisë organike”, kl. 13.

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Bazat e bujqësisë organike”, kl.13, nxënësit duhet:

- Të përkufizojnë konceptin “bujqësi organike”.
- Të përshkruajnë rëndësinë e bujqësisë organike në ditët e sotme.
- Të theksojnë përfitimet ekonomike, shëndetësore dhe ekologjike nga bujqësia organike.
- Të përshkruajnë burimet natyrore të bujqësisë organike si: toka, uji, plehrat, klima etj.
- Të përshkruajnë masat biologjike për ruajtjen e pjellorisë së tokës.
- Të përshkruajnë ndikimet e ujit dhe mbeturinave të tij në bujqësinë organike.
- Të përshkruajnë agroteknologjinë e prodhimit organik duke përfshirë farën si material gjenetik, masat agroteknike të procesit biologjik nga fara te produkti, si dhe mbrojtjen e integruar në bujqësi.
- Të bëjnë dallimin prodhimet *BIO* nga *OMGJ*.
- Të përshkruajnë mënyrat e përfutimit të *OMGJ*-ve nëpërmjet mutacioneve natyrore, trajtimeve kimike të farës, si dhe trajtimeve të farës me rrezatim.
- Të përshkruajnë se si bëhen kontrolli i barërëve të këqinj.
- Të përshkruajnë praktikën e mbarështrimit të kafshëve në ferma organike.
- Të përshkruajnë bazat e të ushqyerit organik, dhe ndikimet e tij në produktet blegtorale.
- Të përshkruajnë shëndetin natyral të kafshëve.
- Të përshkruajnë mënyrën e rritjes së gjallesave ujore (akuakulturën).
- Të theksojnë karakteristikat e bujqësisë tradicionale në vendin tonë.
- Të përshkruajnë rrugët e transformimit të bujqësisë tradicionale në organike.
- Të përshkruajnë procesin e projektimit të një ferme organike sipas zonave klimaterike.
- Të përshkruajnë rëndësinë ekonomike dhe mjedisore të kultivimit të bimëve pa tokë.
- Të theksojnë mënyrat e kultivimit të bimëve pa tokë.
- Të përshkruajnë mënyrën e kultivimit të bimëve në ujë, pa tokë – hidroponia.
- Të përshkruajnë mënyrën e kultivimit të bimëve në ajër, pa tokë dhe pa ujë – aeroponia.

- Të përshkruajnë rëndësinë e njohjes së legjislacionit të prodhimeve *BIO*.
- Të theksojnë legjislacionin e certifikimit dhe të tregëtimit të produkteve organike.
- Të përshkruajnë mënyrat e tregëtimit të produkteve organike.
- Të theksojnë mundësitë potenciale të zhvillimit të bujqësisë organike në Shqipëri, në format e agroturizmit, bujqësisë ekologjike dhe sportive.

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Bazat e bujqësisë organike”, kl.13 - 64 orë**

<b>Tema 1</b>	Kuptimi, rëndësia dhe përparësitë e bujqësisë organike	4 orë
<b>Tema 2</b>	Burimet natyrore dhe administrimi i tyre	10 orë
<b>Tema 3</b>	Agroteknologjia e prodhimit organik	10 orë
<b>Tema 4</b>	Larmia biologjike	3 orë
<b>Tema 5</b>	Organizmat e modifikuara gjenetikiisht ( <i>OMGJ</i> )	2 orë
<b>Tema 6</b>	Mbarështrimi organik i kafshëve. Akuakultura organike	7 orë
<b>Tema 7</b>	Kalimi nga bujqësia tradicionale në organike	6 orë
<b>Tema 8</b>	Kultivimi i bimëve pa tokë.	5 orë
<b>Tema 9</b>	Legjislacioni dhe rregullat e certifikimit dhe tregëtimit të prodhimeve <i>BIO</i>	4 orë
<b>Tema 10</b>	Mundësitë potenciale të zhvillimit të bujqësisë organike në Shqipëri	3 orë
<b>Tema 11</b>	<u>Vizitë mësimore</u> për njohjen konkrete të fermave organike në rajon	5 orë
<b>Tema 12</b>	<u>Veprimtari praktike</u> për rritjen e ndjeshmërisë dhe interesit të komunitetit rajonal për bujqësinë organike dhe prodhimet <i>BIO</i> .	5 orë

## IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale të detyruar

### 1. Moduli “Hapja e një biznesi bujqësor”

Drejtimi: Bujqësi  
Niveli: IV i KSHK  
Klasa: 13

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli	HAPJA E NJË BIZNESI BUJQËSOR	M-17-841-21
Qëllimi i modulit	Një modul që i aftëson nxënësit për të kryer veprimet dhe hartuar dokumentat për hapjen e veprimtarisë ekonomike të një biznesi apo ferme bujqësore.	
Kohëzgjatja e modulit	30 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për praninë	Nxënësit duhet të kenë përfunduar një nga profilet mësimore të nivelit III të KSHK, të drejtimit mësimor “Bujqësi”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	<b>RM 1 Nxënësi krijon “fermën” e simuluar.</b> <b>Kriteret e vlerësimit:</b> Nxënësi duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none"><li>- të përgatitë vendin dhe mjetet e nevojshme të punës për krijimin e “fermës” së simuluar.</li><li>- të përcaktojë qartë qëllimin e drejtimit të fermës së simuluar (bujqësor, blegtoral, mikse);</li><li>- të përcaktojë qartë llojin e prodhimit bujqësor (bimë arash, perime, drufrutorët etj.) dhe blegtoral (mish, qumësht, vezë etj.) në të cilën do të zhvillohet veprimtaria;</li><li>- të përcaktojë emrin e fermës duke pasur parasysh veprimtarinë dhe qëllimin e saj;</li><li>- të përcaktojë qartë cilat do të jenë ngjyrat, logo, sloganet, pamjet me të cilat do të identifikohet më pas ferma.</li><li>- të përzgjedhë formën juridike më të përshtatshme për fermën, sipas mundësive të financimit.</li><li>- të hartojë një statut dhe një akt të thjeshtë të themelimit të “fermës” së simuluar;</li><li>- të përcaktojë mënyrën për derdhjen e kapitalit fillestar;</li><li>- të llogarisë saktë koston e parashikuar për njësi të produktit ose shërbimit objekt të veprimtarisë;</li><li>- të llogarisë saktë koston e tjera të parashikuara variabël dhe fikse për ushtrimin e veprimtarisë;</li><li>- të pasqyrojë saktë shpenzimet e parashikuara për reklamën dhe marketimin e produkteve dhe shërbimeve bujqësore;</li></ul>	



- 
- të hartojë pasqyra të sakta dhe të qarta të parashikimit të rezultatit;
  - të hartojë planin e biznesit duke përmbledhur në të të gjitha parashikimet e kryera;
  - të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm gjatë krijimit të “fermës” së simuluar;
  - të plotësojë dokumentacionin teknik gjatë krijimit të “fermës” së simuluar;
  - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë krijimit të “fermës” së simuluar.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Pyetje- përgjigje
- Vëzhgim me listë kontrolli.

**RM 2 Nxënësi aplikon për licensim dhe regjistrim në organet përkatëse për “fermën” e simuluar.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të identifikojë informacionin në faqen zyrtare të QKB mbi procedurën dhe dokumentat e licencimit të fermave bujqësore;
- të plotësojë saktë formularët e aplikimit për licensim dhe të gjithë dokumentet që duhet të shoqërojnë aplikimin e fermës së simuluar;
- të liçensohet pranë organeve përkatëse duke ndjekur afatet e liçencimit;
- të marrë në dorëzim çertifikatat e liçensimit të fermës së simuluar.
- të paraqitet në afatin e caktuar në zyrat e shërbimeve të tatimpaguesve për tërheqjen e kodit të aksesit në faqen e tatimeve të biznesit për fermën e simuluar;
- të plotësojë saktë dokumentacionin e kërkuar nga organet tatimore lokale;
- të paraqesë në afat dokumentacionin në organet tatimore lokale, shlyejë detyrimet duke institucionalizuar marrëdhëniet me to;
- të plotësojë saktë dhe paraqesë në kohë dokumentat për regjistrim në zyrat e inspektoriatit të punës;
- të deklarojë saktë online personelin e punësuar rishtazi, në momentin e çeljes së veprimtarisë së fermës së simuluar;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm gjatë aplikimit dhe regjistrimit të “fermës së simuluar”;
- të plotësojë dokumentacionin teknik gjatë aplikimit dhe regjistrimit të “fermës së simuluar”;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë aplikimit dhe regjistrimit të “fermës së simuluar”;

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Pyetje- përgjigje
- Vëzhgim me listë kontrolli.



**RM 3 Nxënësi organizon “fermën” e simuluar sipas modelit të fermave reale.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatitë vendin dhe mjetet e nevojshme të punës për organizimin e “fermës” së simuluar sipas modelit të fermave reale.
- të hartojë dhe paraqesë saktë strukturën organizative të fermës bujqësore që do të krijohet për praktikën profesionale;
- të organizojë dosjet personale, sipas sektorëve të blerjes, shitjes, sekretarisë, magazinës, kontabilitetit;
- të plotësojë saktë dosjen personale dhe dokumentacionin e saj sipas modeleve të përdorshme të fermës;
- të plotësojë paraprakisht të gjithë formularët dhe dokumentet model që nevojiten për pasqyrimin e veprimtarisë së fermës;
- të evidentojë saktë dallimet ndërmjet organizimit dhe dokumentimit në fermë dhe në praktikën profesionale në shkollë gjatë krijimit të “fermës” së simuluar;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm gjatë organizimit të “fermës” së simuluar;
- të plotësojë dokumentacionin teknik gjatë organizimit të “fermës së simuluar”;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë organizimit të “fermës” së simuluar.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

**RM 4 Nxënësi harton inventarin, bilancin fillestar dhe dokumentat kontabël të fermës së simuluar.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatitë vendin dhe mjetet e nevojshme të punës për hartimin e inventarit, bilancit fillestar dhe dokumentave kontabël të fermës së simuluar.
- të hartojë saktë listën e elementëve pasurore të nevojshëm për funksionimin e fermës së simuluar;
- të vlerësojë saktë pasurinë fillestare të nevojshme të fermës së simuluar për ushtrimin e veprimtarisë përkatëse, në lloje dhe sasi;
- të hartojë në mënyrën e duhur një inventar fillestar të thjeshtë të fermës së simuluar;
- të përcaktojë saktë totalin e nevojshëm të investimeve për të filluar veprimtarinë në fermën e simuluar;
- të grupojë saktë elementët pasurorë sipas afateve të përdorimit të tyre në fermën e simuluar;
- të plotësojë saktë dosjen personale dhe dokumentacionin e

- saj sipas modeleve të përdorshme të fermës;
- të plotësojë paraprakisht të gjithë formularët dhe dokumentet model që nevojiten për pasqyrimin e veprimtarisë së fermës.
  - të evidentojë saktë dallimet ndërmjet organizimit dhe dokumentimit në fermë dhe në praktikën profesionale në shkollë gjatë krijimit të “fermës” së simuluar.
  - të hartojë saktë bilancin fillestar të fermës, bazuar në investimet e financimet e llogaritura në sasi dhe lloje.
  - të evidentojë saktë se cilët regjistra kontabël do të përdoren për pasqyrimin e veprimtarisë;
  - të hartojë saktë regjistrat në formë modelesh të cilat mund të përdoren më vonë në veprimtarinë e fermës;
  - të evidentojë dallimet dhe karakteristikat e përbashkëta të regjistrave kontabël të përdorur në ndërmarrje me ato që përdoren për praktikën në shkollë;
  - të regjistrojë saktë të dhënat kontabël të gjendjeve të bilancit fillestar në regjistrat përkatës.
  - të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm gjatë hartimit të dokumentave të “fermës” së simuluar.
  - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë hartimit të dokumentave të “fermës” së simuluar.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim më listë kontrolli

---

**Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.**

- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset për praktikat profesionale pranë shkollës ( kabinetit firmës ushtrimore) si dhe në ferma reale.
- Mësuesi duhet të informojë nxënësit në lidhje me informacionin e mbledhur mbi fermën, t’i orientojë ata për mënyrën e seleksionimit të këtij informacioni, për ndarjen në sektorët bazë të fermës.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për të krijuar fermën, organizuar, hartuar dokumentacionet e nevojshme dhe organizuar dosjet përkatëse.
- Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me proceset e punës në fermë duke e krahasuar atë me praktikën mësimorë në shkollë.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës për krijimin, organizimin, hartimin e dosjeve të fermës, si dhe paraqitjen e rezultateve të arritura.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

---

**Kushtet e  
e domosdoshme  
për realizimin e  
modulit**

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Zyrë mësimore ( kabinet) dhe ferma reale. Kompjuter.
  - Formularë dokumentash model të formuluar nga mësuesi.
  - Formularë dokumentash model të fermave reale.
  - Materiale mësimore të lëndës “Baza e sipërmarrjes”, “Drejtimi, ligjshmëria dhe ekonomia në bujqësi” lidhur me tematikat përkatëse.
-

## 2. Moduli “Vlerësimi i tokës për prodhim BIO”

Drejtimi: Bujqësi  
Niveli: IV i KSHK  
Klasa: 13

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	VLERËSIMI I TOKËS PËR PRODHIM BIO	M-14-845-21
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i aftëson nxënësit të përcaktojnë me metoda të thjeshta aftësinë e tokës për të prodhuar produkte BIO.	
Kohëzgjatja e modulit	33 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar një nga profilet mësimore të nivelit III të KSHK, të drejtimit mësimor “Bujqësi”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	<b>RM 1 Nxënësi vlerëson praninë e qenieve të gjalla në tokë.</b> <b>Kriteret e vlerësimit:</b> Nxënësi duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none"><li>- të veshë uniformën gjatë vlerësimit të pranisë së qenieve të gjalla në tokë;</li><li>- të përzgjedhë veglat, pajisjet dhe materialet e nevojshme për vlerësimin të pranisë së qenieve të gjalla në tokë;</li><li>- të kryejë kontrollin teknik vizual të zakonshëm të veglave dhe mjeteve të punës për vlerësimin e pranisë së qenieve të gjalla në tokë.</li><li>- të përcaktojë parcelën e tokës ku do të bëhet vëzhgimi sipas pranisë së bimësisë në të.</li><li>- të përzgjedhë dhe transportojë mjetet e duhura të punës (bel, lopatë) për hapjen e profilit të tokës.</li><li>- të hapë profilin e tokës në thellësinë 30-40 cm.</li><li>- të nxjerrë dheun pa dëmtuar gjallesat.</li><li>- të numërojë gjallesat.</li><li>- të vëzhgojë me kujdes dhe vlerësojë gjallesat në tokë duke shënuar numrin e tyre dhe llojin e tyre (krimba, kërpudha etj.).</li><li>- të plotësojë dokumentacionin teknik gjatë vlerësimit të pranisë së qenieve të gjalla në tokë;</li><li>- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me punimet e kryera;</li><li>- të plotësojë faturën financiare për punimet e kryera.</li><li>- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me eprorët, klientët dhe kolegët gjatë vlerësimit të pranisë së qenieve të gjalla në tokë;</li><li>- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë vlerësimit të pranisë së qenieve të gjalla në</li></ul>	

---

tokë;

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

**RM 2 Nxënësi vlerëson sasinë e rrënjëve në tokë.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën dhe pajisjet e duhura mbrojtëse gjatë vlerësimit të sasisë së rrënjëve në tokë;
- të përzgjedhë veglat, pajisjet dhe materialet e nevojshme për vlerësimin të sasisë së rrënjëve në tokë;
- të kryejë kontrollin teknik vizual të zakonshëm të veglave dhe mjeteve të punës për vlerësimin e sasisë së rrënjëve në tokë;
- të përcaktojë parcelën e tokës ku do të bëhet vëzhgimi e vlerësimi i rrënjëve sipas pranisë së bimësisë në të;
- të përzgjedhë dhe transportojë mjetet e duhura të punës (bel) për hapjen e tokës;
- të hapë profilin e tokës në thellësinë rreth 50 cm;
- të vendosë kasën e shkallëzuar pa dëmtuar rrënjët;
- të vëzhgojë me kujdes gjatësinë, gjerësinë dhe hollësinë e rrënjëve;
- të vlerësojë sipas parametrave sasinë e rrënjëve;
- të plotësojë dokumentacionin teknik gjatë vlerësimit të sasisë së rrënjëve në tokë;
- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me punimet e kryera;
- të plotësojë faturën financiare për punimet e kryera;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me eprorët, klientët dhe kolegët gjatë vlerësimit të sasisë së rrënjëve në tokë;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë vlerësimit të sasisë së rrënjëve në tokë.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

**RM 3 Nxënësi nxjerr kampionin e tokës me metodën e belit**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën dhe pajisjet e duhura mbrojtëse gjatë nxjerrjes së tokës me bel;
- të përzgjedhë veglat, pajisjet dhe materialet e nevojshme për nxjerrjen e tokës me bel;
- të kryejë kontrollin teknik dhe vizual të zakonshëm të veglave dhe mjeteve të punës për nxjerrjen e tokës me bel;
- të përcaktojë tokën ku do të merret kampioni sipas kriteve teknike;
- të përzgjedhë dhe transportojë mjetet e thjeshta (bel) sipas llojit të kampionit të tokës;

- të ngulë belin në tokë në pozicionin e parë në thellësinë 15-20 cm dhe të heqë gjithë shtresën që merr beli;
- të ngulë belin në pozicionin e dytë 10 cm pas të parit dhe të lëvizë belin anash (jo para-mbrapa pasi shkakton ngjeshje të tokës);
- të nxjerrë saktë kampionin e dheut dhe ta mbështetesë atë në tokë me kujdes;
- të plotësojë dokumentacionin teknik gjatë nxjerrjes së tokës me bel;
- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me punimet e kryera;
- të plotësojë faturën financiare për punimet e kryera;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me eprorët, klientët dhe kolegët gjatë nxjerrjes së tokës me bel;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë nxjerrjes së tokës me bel.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

**RM 4 Nxënësi vlerëson tokën për kultivimin e bimëve biologjike.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- Të veshë uniformën dhe pajisjet e duhura mbrojtëse gjatë vlerësimit të tokës për kultivimin e bimëve biologjike;
- të përzgjedhë veglat, pajisjet dhe materialet e nevojshme për vlerësimin e tokës për kultivimin e bimëve biologjike;
- të kryejë kontrollin teknik vizual të zakonshëm të veglave dhe mjeteve të punës për vlerësimin e tokës për kultivimin e bimëve biologjike;
- të vëshgojë ngjyrën, aromën dhe lagështinë e tokës sipas parametrave teknikë;
- të hedhë kampionin e dheut nga një lartësi rreth 1 m;
- të vëshgojë shkrifërimin dhe porozitetin e tokës pas hedhjes së tokës sipas provës me gishta;
- të vlerësojë cilësinë e tokës për kultivimin e bimëve biologjike;
- të plotësojë dokumentacionin teknik gjatë vlerësimit të tokës për kultivimin e bimëve biologjike;
- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me punimet e kryera;
- të plotësojë faturën financiare për punimet e kryera;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me eprorët, klientët dhe kolegët gjatë vlerësimit të tokës për kultivimin e bimëve biologjike;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë vlerësimit të tokës për kultivimin e bimëve biologjike.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

---

**Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.**

- Ky modul mund të trajtohet në fermën e shkollës, në ferma të tjera pranë shkollës sipas mundësive që ofron zona apo rajoni ku ndodhet shkolla.
- Gjatë trajtimit të modulit mësuesi i praktikës duhet të përdorë demonstrime konkrete të kryerjes së vlerësimit të pranisë së gjallesave në tokë, të sasisë së rrënjëve, nxjerrjes së kampionit të tokës me metodën e belit, si dhe për vlerësimin e tokës për kultivimin biologjik të kulturave.
- Mësuesi/instruktori mund të organizojë vizita mësimore apo takime me eksperte bujqësie për shkëmbimin e përvojave mbi vlerësimin e tokës për bujqësinë organike.
- Nxënësit duhet të praktikohen sa më shumë të jetë mundur në kryerjen së vlerësimit të pranisë së gjallesave në tokë, të sasisë së rrënjëve, nxjerrjes së kampionit të tokës me metodën e belit, si dhe për vlerësimin e tokës për kultivimin biologjik të kulturave.
- Mësuesi i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë vlerësimit të tokës për bujqësinë biologjike.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike të vlerësimit të pranisë së gjallesave në tokë, të sasisë së rrënjëve, nxjerrjes së kampionit të tokës me metodën e belit, si dhe për vlerësimin e tokës për kultivimin biologjik të kulturave.

---

**Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit**

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:

- Ferma e shkollës.
  - Pajisje kancelarie.
  - Vegla të thjeshta për hapjen e profilit.
  - Katologë apo manualë me të dhëna standarde për parametrat biologjik të tokës bujqësore.
-

#### 4. Moduli “Prodhimi i produkteve organike në fermën bujqësore”

(Ky modul është hartuar me mbështetjen Projektit “Aleanca për Zhvillimin dhe Vlerësimin e Bujqësisë Familjare në Veri të Shqipërisë”, zbatuar nga COSPE dhe “Agjencia Italiane për Bashkëpunim dhe Zhvillim”)

**Drejtimi:** Bujqësi  
**Niveli:** IV i KSHK  
**Klasa:** 13

##### PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	PRODHIMI I PRODUKTEVE ORGANIKE NË FERMËN BUJQËSORE	M-14-1718-21
<b>Qëllimi i modulit</b>	Një modul praktik që i aftëson nxënësit për të zbatuar teknikat e prodhimit të produkteve organike në fermat bujqësore, si dhe për të kryer llogaritje të thjeshta ekonomike që lidhen me këto punime.	
<b>Kohëzgjatja e modulit</b>	36 orë mësimore	
<b>Niveli i parapëlqyer për praninë</b>	Nxënësit duhet të kenë përfunduar një nga profilet mësimore të nivelit III të KSHK, të drejtimit mësimor “Bujqësi”.	
<b>Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit</b>	<b>RM 1 Nxënësi përgatit tokën për mbjelljen e kulturave për prodhim organik.</b> <b>Kriteret e vlerësimit.</b> Nxënësi duhet të jetë i aftë <ul style="list-style-type: none"><li>- të veshë uniformën dhe pajisjet e duhura mbrojtëse gjatë punimit bazë dhe plotësues të tokës;</li><li>- të përzgjedhë veglat, pajisjet dhe materialet e nevojshme për punimit bazë dhe plotësues të tokës;</li><li>- të kryejë kontrollin teknik vizual të zakonshëm të veglave dhe mjeteve të punës për punimin bazë dhe plotësues të tokës;</li><li>- të bëjë përshtatjen e veglave dhe mjeteve të punës sipas llojit të punimit;</li><li>- të kryejë shpërndarjen e plehërave organike;</li><li>- të kryejë punimin bazë të tokës me vegla të thjeshta ose të mekanizuara sipas llojit të punimit;</li><li>- të kontrollojë cilësinë e punimit bazë dhe plotësues të tokës sipas llojit të punimit;</li><li>- të pastrojë veglat dhe mjetet e punës pas përdorimit të tyre;</li><li>- të kujdeset për veglat, pajisjet dhe materialet e punës gjatë dhe pas përdorimit të tyre;</li><li>- të plotësojë dokumentacionin teknik për punimet bazë dhe plotësuese të tokës;</li><li>- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me</li></ul>	



- 
- punimet e kryera;
  - të plotësojë faturën financiare për punimet e kryera;
  - të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me eprorët, klientët dhe kolegët gjatë punimit bazë të tokës;
  - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë punimit bazë dhe plotësues të tokës.

***Instrumentet e vlerësimit.***

- Vëzhgim me listë kontrolli

---

**RM 2 Nxënësi zbaton agroteknologjinë e kultivimit organik të kulturave bujqësore.**

***Kriteret e vlerësimit.***

Nxënësi duhet të jetë i aftë.

- të veshë uniformën dhe pajisjet e duhura mbrojtëse gjatë agroteknologjinë e kultivimit të kulturave bujqësore;
- të përzgjedhë veglat, pajisjet dhe materialet e nevojshme për e kultivimit të kulturave bujqësore;
- të transportojë veglat, pajisjet dhe materialet e nevojshme për e kultivimit të kulturave bujqësore;
- të njihet me mënyrën dhe modelet e zbrërthimit të planit të realizimit të mbjelljeve të kulturave bujqësore për prodhim organik;
- të zbrërthejë planin e mbjelljeve të fushës sipas udhëzimeve përkatëse;
- të përllogaritë dendësinë e mbjelljes, sipas distancave dhe mënyrës së mbjelljes së kulturave bujqësore;
- të përllogaritë sasinë e nevojshme të materialit mbjellës, sipas sipërfaqes së parcelës që do të mbillet me kultura bujqësore;
- të sigurojë materialin mbjellës të përllogaritur për mbjellje, sipas standardeve të bujqësisë organike.
- të përgatitë materialin mbjellës për mbjellje, sipas llojit të kulturës dhe standardeve përkatëse;
- të kryejë piketimin e saktë të ngastrave sipas distancave të mbjelljes së kulturave bujqësore;
- të realizojë mbjelljen sipas distancave të mbjelljes së kulturave bujqësore;
- të kryejë shërbimet agroteknike menjëherë pas mbjelljes sipas nevojës së kulturave bujqësore;
- të realizojë rrallimin dhe prashitjen e kulturave sipas nevojës së kulturave bujqësore;
- të plotësojë nevojat e kulturave bujqësore për ujë sipas nevojave, duke zbatuar metodat më efikente të ujitjes së tyre;
- të plotësojë nevojat e kulturave bujqësore për elementë ushqyes, sipas nevojave të tyre dhe mbështetur në standardet e bujqësisë organike.
- Të kujdeset për shëndetësimin e kulturave bujqësore, sipas standardeve të bujqësisë organike.
- Të kryejë vjeljen e prodhimit organik të kulturave

---

bujqësore, sipas specifikave të kulturave bujqësore dhe standardeve përkatëse.

- Të magazinohet prodhimin organik në vendin e caktuar për ruajtje.
- Të seleksionohet dhe paketojë prodhimin organik sipas kërkesave dhe standardeve të bujqësisë organike.
- Të përgatitet dhe vendoset etiketat me të gjitha të dhënat e duhura të prodhimit organik, sipas standardit të kërkuar.
- Të kujdeset për ruajtjen e produkteve organike në kushte optimale të ruajtjes në përputhje me standardet përkatëse
- të pastrojë vendin dhe mjetet e punës gjatë zbatimit të agroteknologjisë së kultivimit organik të kulturave bujqësore.
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm gjatë zbatimit të agroteknologjisë së kultivimit organik të kulturave bujqësore.
- të plotësojë dokumentacionin teknik gjatë zbatimit të agroteknologjisë së kultivimit organik të kulturave bujqësore.
- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me punimet e kryera;
- të plotësojë faturën financiare për punimet e kryera;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë zbatimit të agroteknologjisë së kultivimit organik të kulturave bujqësore.

***Instrumentet e vlerësimit.***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

---

**Udhëzime për zbatimin e modulit**

- Ky modul duhet të trajtohet në fermën e shkollës ose në fermë të prodhimit bujqësor dhe blegtoral pranë saj.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrime konkrete për kultivimin organik të kulturave bujqësore dhe mbarështimit organik të kafshëve bujqësore si dhe llogaritjet e thjeshta ekonomike që lidhen me këto procese.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për zbatimin e agroteknologjisë së kultivimit organik të kulturave bujqësore dhe mbarështimit të kafshëve bujqësore.
- Nxënësit duhet të përfshihen në kryerjen e llogaritjeve të thjeshta ekonomike të proceseve të punës .
- Instruktori i praktikës duhet të mbikqyrë edhe përdorimin e mirëmbajtjen e veglave dhe mjeteve që agroteknologjisë së kultivimit organik të kulturave bujqësore dhe mbarështimit të kafshëve bujqësore.
- Instruktori i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit gjatë punës agroteknologjisë së kultivimit organik të kulturave bujqësore dhe mbarështimit të kafshëve bujqësore.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike të zbatimit

---

agroteknologjisë së kultivimit organik të kulturave bujqësore dhe mbarështimit të kafshëve bujqësore si dhe të llogaritjeve të thjeshta ekonomike që lidhen me këtë proces.

---

**Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit**

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohet mjedisi i përshtatshëm, veglat, pajisjet, dhe baza materiale e mëposhtme.

- Baza prodhuese e shkollës apo fermë e prodhimit bujqësor dhe blegtoral afër saj.
  - Traktor.
  - Makine mbjellse
  - Vegla dhe pajisje të thjeshta pune për mbjellje e tokës.
  - Vegla dhe pajisje pune për shërbimet kulturore të bimëve.
  - DVD, video, CD, pankarka, skica apo modele të planit të mbjelljes së bimëve.
  - Makina për pastrimin e stallës.
  - Makina për shpërndarjen e ushqimit të kafshëve.
  - Makina mjelse.
  - Pajisje kancelarie.
  - Makina llogaritëse dore.
  - Manualet e preventivimit dhe për zbërthimin e kostos.
  - Përmbledhje e legjislacionit në fushën e prodhimit bimor (kodi i punës, legjislacioni fiskal).
  - Modele të dokumentacionit financiar dhe fiskal.
-

#### 4. Moduli “Zbatimi i planit të masave të mbrojtjes së integruar në bujqësi”

**Drejtimi:** Bujqësi  
**Niveli:** IV i KSHK  
**Klasa:** 13

##### PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	ZBATIMI I PLANIT TË MASAVE TË MBROJTJES SË INTEGRUAR NË BUJQËSI	M-14-844-21
<b>Qëllimi i modulit</b>	Modul praktik që i pajis nxënësit me aftësi praktike për të organizuar punën, kryer kontrollë fushore, si dhe zbatuar planin e masave të mbrojtjes së integruar të kulturave bujqësore ndaj dëmtuesve, sëmundjeve dhe barishteve të këqija.	
<b>Kohëzgjatja e modulit</b>	33 orë mësimore	
<b>Niveli i parapëlqyer për pranim</b>	Nxënësit duhet të kenë përfunduar një nga profilet mësimore të nivelit III të KSHK, të drejtimit mësimor “Bujqësi”.	
<b>Rezultatet e të mësuarit (RM), dhe procedurat e vlerësimit</b>	<b>RM 1 Nxënësi kryen kontroll fushor.</b> <b>Kriteret e vlerësimit:</b> Nxënësi duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none"><li>- të veshë uniformën dhe pajisjet e duhura mbrojtëse gjatë kryerjes së kontrollit fushor;</li><li>- të përzgjedhë veglat, pajisjet dhe materialet e nevojshme për kryerjen e kontrollit fushor;</li><li>- të kryejë kontrollin teknik vizual të zakonshëm të veglave dhe mjeteve të punës për kryerjen e kontrollit fushor;</li><li>- të përcaktojë saktë qëllimin e kontrollit fushor: për dëmtues, sëmundje apo barishte të këqija;</li><li>- të përzgjedhë llojin e kulturës; bimë arash, perime, drufrutorë etj., dhe e parcelave për kontroll;</li><li>- të hartojë planin e vrojtimit për një parcelë të dhënë, duke përfshirë datat dhe kohën e saktë të kryerjes së vrojtimit;</li><li>- të përcaktojë fazën biologjike të kulturës sipas karakteristikave të rritjes normale;</li><li>- të identifikojë bimët e infektuara në parcelë sipas karakteristikave të rritjes jo normale të tyre;</li><li>- të diagnostikojë saktë shkakun e infeksionit: dëmtues, sëmundje apo barishte të këqija;</li><li>- të përcaktojë shkallën e infeksionit nëse është në rritje apo në rënie;</li><li>- të bëjë vlerësimin e përgjithshëm të gjendjes së kulturës;</li><li>- të realizojë me korrektësi planin e kontrollit fushor duke respektuar datat dhe kohën e vrojtimit;</li><li>- të mbajë saktë shënimet për parcelën e monitoruar lidhur me</li></ul>	

- 
- bimët, dëmtuesin, prodhimin bimor, shkallën e përhapjës së dëmtuesit etj.;
- të plotësojë saktë dokumentacionin përkatës të kontrollit fushor;
  - të analizojë të dhënat për të përcaktuar dëmin ekonomik të shkaktuar nga infektimi të ndryshme;
  - të krahasojë gjendjen aktuale të kulturës së përzgjedhur me standardin e lejuar ekonomik (pragu ekonomik) për të ndërhyrë për mbrojtjen e tyre;
  - të raportojë (të bëjë me dije) të dhënat e kontrollit fushor në instanca më të larta përgjegjëse për marrjen e masave të kontrollit;
  - të zbatojë rregullat e ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së kontrollit fushor të infektimit të kulturave nga dëmtues, sëmundje apo barishte të këqija;
  - të plotësojë dokumentacionin teknik gjatë vlerësimit të tokës për kryerjen e kontrollit fushor;
  - të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me punimet e kryera;
  - të plotësojë faturën financiare për punimet e kryera;
  - të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me eprorët, klientët dhe kolegët gjatë kryerjes së kontrollit fushor;
  - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë kryerjes së kontrollit fushor;

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

**RM 2 Nxënësi zbaton masat e mbrojtjes së integruar të kulturave bujqësore nga dëmtuesit.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën dhe pajisjet e duhura mbrojtëse gjatë zbatimit të masave të mbrojtjes së integruar të kulturave bujqësore nga dëmtuesit;
- të përzgjedhë veglat, pajisjet dhe materialet e nevojshme për zbatimin e masave të mbrojtjes së integruar të kulturave bujqësore nga dëmtuesit;
- të kryejë kontrollin teknik vizual të zakonshëm të veglave dhe mjeteve të punës për zbatimin e masave të mbrojtjes së integruar të kulturave bujqësore nga dëmtuesit;
- të zbatojë masat agroteknike të mbrojtjes së kulturave ndaj dëmtuesve, të tilla si:
  - pastrimi dhe higjienizimi i vendit apo zonës së infektuar;
  - punimi i tokës;
  - mbjellja e varieteteve rezistente nga dëmtuesve;
  - qarkullimi bujqësor;
  - bashkëshoqërimi i kulturave bujqësore etj.;
- të zbatojë masat biologjike të mbrojtjes së kulturave ndaj

- dëmtuesve, të tilla si:
- kujdesi për ruajtjen e “grabitqarëve” të dëmtuesve;
  - përdorimi i insekticideve selective që janë pak ose aspak të dëmshëm ndaj këtyre ‘gabitqarëve’;
  - shfrytëzimi i “grabitqarëve” natyror etj.;
- të zbatojë masat fiziko-mekanike të mbrojtjes së kulturave ndaj dëmtuesve, të tilla si:
- përdorimi i metodës së ftohtë apo të nxehtë, për vrasjen e dëmtuesve apo ngadalësimin e rritjes;
  - përdorimi i rrjetave të posaçme apo grackave për kapjen e dëmtuesve etj.;
- të zbatojë masat kimike të mbrojtjes së kulturave ndaj dëmtuesve:
- përdorimi i feromoneve;
  - përdorimi i rregullatorëve të rritjes së insekteve dhe dëmtuesve;
  - përdorimi i sterilizantëve etj.;
- të llogarisë koston e zbatimit të masave të mbrojtjes së bimëve nga dëmtuesit;
- të zbatojë rregullat e ruajtjes së mjedisit gjatë zbatimit të masave të mbrojtjes së integruar të kulturave ndaj dëmtuesve, duke konsideruar kushtet e zbatimit dhe ndikimin e tyre në mjedis;
- të plotësojë dokumentacionin teknik gjatë zbatimit të masave të mbrojtjes së integruar të kulturave bujqësore nga dëmtuesit;
- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me punimet e kryera;
- të plotësojë faturën financiare për punimet e kryera;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me eprorët, klientët dhe kolegët gjatë zbatimit të masave të mbrojtjes së integruar të kulturave bujqësore nga dëmtuesit;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë zbatimit të masave të mbrojtjes së integruar të kulturave bujqësore nga dëmtuesit.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

**RM 3 Nxënësi zbaton masat e mbrojtjes së integruar të kulturave bujqësore nga sëmundjet.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën dhe pajisjet e duhura mbrojtëse gjatë zbatimit të masave të mbrojtjes së integruar të kulturave bujqësore nga sëmundjet;
- të përzgjedhë veglat, pajisjet dhe materialet e nevojshme për zbatimin e masave të mbrojtjes së integruar të kulturave bujqësore nga sëmundjet;
- të kryejë kontrollin teknik vizual të zakonshëm të veglave

- dhe mjeteve të punës për zbatimin e masave të mbrojtjes së integruar të kulturave bujqësore nga sëmundjet;
- të zbatojë masat agroteknike të mbrojtjes së kulturave ndaj sëmundjeve, të tilla si:
    - mbajtja e tokës ugar;
    - largimi i barërave të këqija
    - pastrimi dhe higjienizimi i vendit apo zonës me bimë të infektuara;
    - mbjellja e varieteve rezistente nga sëmundjeve;
    - qarkullimi bujqësor i kulturave;
    - heqja me dorë e bimëve apo pjesëve të tyre të prekura nga sëmundje të ndryshme etj.;
  - të zbatojë masat biologjike të mbrojtjes së kulturave ndaj sëmundjeve, të tilla si:
    - përdorimi i organizmave antagonist me sëmundjen;
    - përdorimi i teknikave të tërthorta të mbrojtjes për viruset etj.;
  - të zbatojë masat fiziko-mekanike të mbrojtjes së kulturave ndaj sëmundjeve, të tilla si:
    - trajtimi i bimëve apo i pjesëve të tyre me nxehtësi;
    - përdorimi i metodave specifike të ruajtjes dhe trajtimit të bimëve dhe produkteve bimore etj.;
  - të zbatojë masat kimike të mbrojtjes së kulturave ndaj sëmundjeve, të tilla si:
    - përdorimi i preparateve kimike për mbrojtjen e bimës mbartëse përpara infektimit;
    - përdorimi i pesticideve për zhdukjen e patogjenit, pasi ai ka infektuar bimën mbartëse;
    - përdorimi i preparateve organike specifike për trajtimin e sëmundjeve të shkatuara nga bakteret, viruset, nematodat etj.;
  - të llogarisë koston e zbatimit të masave të mbrojtjes së bimëve nga sëmundjet;
  - të zbatojë rregullat e ruajtjes së mjedisit gjatë zbatimit të masave të mbrojtjes së integruar të kulturave nga sëmundjet, duke konsideruar kushtet e zbatimit dhe ndikimin e tyre në mjedis;
  - të plotësojë dokumentacionin teknik gjatë zbatimit të masave të mbrojtjes së integruar të kulturave bujqësore nga sëmundjet;
  - të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me punimet e kryera;
  - të plotësojë faturën financiare për punimet e kryera;
  - të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me eprorët, klientët dhe kolegët gjatë zbatimit të masave të mbrojtjes së integruar të kulturave bujqësore nga sëmundjet;
  - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë zbatimit të masave të mbrojtjes së integruar të kulturave bujqësore nga sëmundjet.

**Instrumentet e vlerësimit:**

- Vëzhgim me listë kontrolli.

**RM 4 Nxënësi zbaton masat e mbrojtjes së bimëve nga barërat e këqija.**

**Kriteret e vlerësimit:**

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën dhe pajisjet e duhura mbrojtëse gjatë zbatimit të masave të mbrojtjes së bimëve nga barërat e këqija;
- të përzgjedhë veglat, pajisjet dhe materialet e nevojshme për zbatimin e masave të mbrojtjes së bimëve nga barërat e këqija;
- të kryejë kontrollin teknik vizual të zakonshëm të veglave dhe mjeteve të punës për gjatë zbatimit të masave të mbrojtjes së bimëve nga barërat e këqija;
- të zbatojë masat agroteknike të mbrojtjes së kulturave ndaj barishtet e këqija, të tilla si: shkulja me dorë e barishteve të këqija;
  - shkulja me anë të prashitjeve e barishteve të këqija;
  - lesimi i tokës;
  - përdorimi i farës së pastër nga farërat e barishteve;
  - mbjellja e kulturave konkurruese ndaj barishteve të këqija;
  - qarkullimi i kulturave bujqësore;
  - bashkëshoqërimi i kulturave etj.;
- të zbatojë masat kimike të mbrojtjes së kulturave ndaj barishtet e këqija, të tilla si:
  - përdorimi i herbicideve selektive sipas llojit dhe fazës së zhvillimit të bimës etj.;
  - përdorimi i herbicideve jo selektive;
  - përdorimi i herbicideve të lokalizuara (për gjethe, kërcell etj.).
- të llogarisë koston e zbatimit të masave të mbrojtjes së bimëve nga barërat e këqija;
- të zbatojë rregullat e ruajtjes së mjedisit gjatë zbatimit të masave të mbrojtjes së integruar të kulturave nga barishtet e këqija;
- të plotësojë dokumentacionin teknik gjatë zbatimit të masave të mbrojtjes së bimëve nga barërat e këqija;
- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me punimet e kryera;
- të plotësojë faturën financiare për punimet e kryera;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me eprorët, klientët dhe kolegët gjatë zbatimit të masave të mbrojtjes së bimëve nga barërat e këqija;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë zbatimit të masave të mbrojtjes së bimëve nga barërat e këqija .



**Instrumentet e vlerësimit:**

- Vëzhgim me listë kontrolli.

---

**Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.**

- Ky modul mund të trajtohet në fermën e shkollës, në ferma të tjera pranë shkollës sipas mundësive që ofron zona apo rajoni ku ndodhet shkolla.
- Gjatë trajtimit të modulit mësuesi i praktikës duhet të përdorë demonstrime konkrete të kryerjes së veprimtarive të organizimit të planit të punës, kryerjes së kontrollit të fushave të mbjella, si dhe për zbatimin e planit të masave të mbrojtjes së integruar në bujqësi kundër dëmtuesve, sëmundjeve dhe barërave të këqija.
- Mësuesi/instruktori mund të organizojë vizita mësimore apo takime me eksperte bujqësie për shkëmbimin e përvojave mbi organizimin e planit të punës, kryerjes së kontrollit të fushave të mbjella, si dhe zbatimin e planit të masave të mbrojtjes së integruar në bujqësi kundër dëmtuesve, sëmundjeve dhe barërave të këqija, në familiaritet me mjedisin.
- Nxënësit duhet të praktikohen sa më shumë të jetë mundur në kryerjen e veprimtarive të organizimit të planit të punës, kryerjes së kontrollit të fushave të mbjella, si për zbatimin e planit të masave të mbrojtjes së integruar në bujqësi kundër dëmtuesve, sëmundjeve dhe barërave të këqija.
- Mësuesi i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë zbatimit të planit të masave të mbrojtjes së integruar në bujqësi.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike të organizimit të planit të punës, kryerjes së kontrollit të fushave të mbjella, si dhe të zbatimit të planit të masave të mbrojtjes së integruar në bujqësi kundër dëmtuesve, sëmundjeve dhe barërave të këqija.

---

**Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit**

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:
- Ferma e shkollës.
  - Pajisje kancelarie.
  - Manualet e preventivimit dhe për zberthimin e kostos.
  - Përmbledhje e legjislacionit në fushën e shërbimeve që lidhet me përdorimin e preparateve kimike në bujqësinë/fermat organike (kodi i punës, legjislacioni fiskal).
  - Modele të dokumentacionit financiar dhe fiskal.
-

## 5. Moduli “Blerja dhe shitja e mallrave e shërbimeve në fermën bujqësore”

Drejtimi: Bujqësi  
Niveli: IV i KSHK  
Klasa: 13

### PERSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	<b>BLERJA DHE SHITJA E MALLRAVE E SHËRBIMEVE BUJQËSORE</b>	<b>M-17-1719-21</b>
Qëllimi i modulit	Një modul që i pajis nxënësit me aftësi praktike për të kryer procedurën e blerjes dhe të shitjes së mallrave dhe shërbimeve bujqësore, si dhe për të dokumentuar dhe kryer regjistrimet përkatëse që lidhen me blerjet dhe shitjet e kryera.	
Kohëzgjatja e modulit	60 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar një nga profilet mësimore të nivelit III të KSHK, të drejtimit mësimor “Bujqësi”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	<b>RM 1 Nxënësi studion tregun e blerjes së mallrave.</b> <b>Kriteret e vlerësimit:</b> Nxënësi duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none"><li>– të përgatitë mjetet dhe dokumentat e nevojshme të punës për studimin e tregut të blerjes së mallrave.</li><li>– të përcaktojë saktë objektivat e fermës në fushën e blerjes së mallrave;</li><li>– të përcaktojë grupin dhe llojin e furnitorëve që mund të studiohen;</li><li>– të hartojë saktë listën e kontrollit me detyrat që do të realizohen gjatë studimit të tregut të blerjes duke përcaktuar dhe afatet përkatëse;</li><li>– të përcaktojë saktë përgjegjësitë dhe detyrat gjatë procesit të studimit të tregut;</li><li>– të përpunojë materialet e mbledhura dhe të paraqesë me shkrim rezultate të besueshme dhe të qarta;</li><li>– të hartojë një raport të plotë e të qartë të studimit të tregut;</li><li>– të hartojë saktë listat e furnitorëve potencialë me tërë elementët e domosdoshëm për marrjen e informacionit të duhur për ta;</li><li>– të llogarisë saktë kostot faktike të studimit të tregut të blerjes.</li><li>– të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm gjatë studimit të tregut të blerjes dhe hartimit të dokumentave të “fermës” së simuluar.</li><li>– të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së</li></ul>	

---

mjedisit gjatë studimit të tregut të blerjes dhe hartimit të dokumentave të “fermës” së simuluar.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

**RM 2 Nxënësi vendos marrëdhëniet me furnitorët dhe i dokumenton ato.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatitë mjetet dhe dokumentat e nevojshme të punës për vendosjen e marrëdhënieve me furnitorët.
- të formulojë dhe hapë me tërë elementët përbërës kartelat individuale të furnitorëve;
- të hartojë saktë materialet informuese për fermen dhe kërkesat për bashkëpunim për furnitorët potencialë;
- të dërgojë në rrugë të sigurt materialet informuese për fermen dhe kërkesave bashkëpunim te furnitorët potencialë;
- të përpunojë saktë korrespondencën me furnitorët;
- të regjistrojë saktë informacionin e marrë nga furnitorët;
- të plotësojë kartelat e furnitorëve me kushtet e lëvrimit dhe pagesës që ata ofrojnë;
- të evidentojë saktë furnitorët me të cilët aktualisht do të vendosen marrëdhënie biznesi;
- të hartojë kërkesa të plota dhe të qarta për oferta;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm gjatë vendosjes së marrëdhënieve me furnitorët dhe hartimit të dokumentave të “fermës” së simuluar;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë vendosjes së marrëdhënieve me furnitorët dhe hartimit të dokumentave të “fermës” së simuluar.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

**RM 3 Nxënësi blen dhe rregjistron blerjet përkatëse.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatitë mjetet e nevojshme të punës për kryerjen e blerjeve dhe regjistrimet përkatëse kontabël;
- të kontrollojë gjendjen e magazinës dhe llogarisë saktë nevojat për mallra;
- të hartojë urdhra të plotë dhe të qartë blerjeje;
- të regjistrojë saktë ofertat e marra nga furnitorët;
- të plotësojë saktë formularin e krahasimit të ofertave të mara;
- të krahasojë ofertat dhe llogarisë saktë ofertën më të mirë;
- të kryejë saktë porosinë për blerje;
- të regjistrojë saktë porosinë në regjistrin e porosive të kryera;

- të regjistrojë saktë dëftesën e lëvrimin dhe faturën e mallrave të blera;
- të kryejë kontrollet e plota formale, ligjore dhe faktike të mallrave të blera;
- të regjistrojë saktë blerjet në kartelat e furnitorëve;
- të hartojë saktë dokumentet e marrjes në dorëzim të mallrave në magazinë;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm gjatë blerjes dhe kryerjes së regjistrimeve përkatëse;
- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me blerjet dhe regjistrimet e kryera;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë hartimit të dokumentave të “fermës” së simuluar, blerjes dhe kryerjes së regjistrimeve përkatëse.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

**RM 4 Nxënësi kontabilizon blerjet.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatitë mjetet dhe dokumentat e nevojshme për kontabilizimin e blerjeve.
- të hapë ditarin analitik të blerjeve duke respektuar normativat ligjore në fuqi;
- të regjistrojë saktë blerjen e mallrave apo shërbimeve në ditarin analitik të blerjeve;
- të kryejë regjistrimin e saktë kontabël të rritjes së gjendjes së magazinës në sajë të blerjeve;
- të regjistrojë saktë faturat në regjistrin e faturave të mara;
- të kontrollojë afatet e skadencës së pagesës së tyre.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së regjistrimit kontabël të blerjes dhe hartimit të dokumentave të “fermës” së simuluar.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

**RM 5 Nxënësi përzgjedh formën e duhur kërkimore të tregut të shitjes.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatitë mjetet dhe dokumentat e nevojshme për të përzgjedhur formën e duhur kërkimore të tregut të shitjes;
- të përcaktojë saktë objektivat e fermës në fushën e shitjes;
- të analizojë saktë format e ndryshme të thjeshta të studimit të tregut si: mundësitë që ofrojnë, të metat dhe përparësitë e secilës.
- të pasqyrojë me shkrim, në mënyrë të përmbledhur, rezultatet e analizës;
- të llogarisë saktë kostot për sejcilën formë të të studimit të

tregut;

- të krahasojë kostot e llogaritura për çdo formë të studimit të tregut të shitjes;
- të përzgjedhë formën më të përshtatshme të studimit të tregut në funksion të plotësimin të qëllimit të studimit dhe madhësisë së kostove.
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm gjatë punës kërkimore të tregut të shitjes dhe hartimit të dokumentave të “fermës” së simuluar;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë punës kërkimore të tregut të shitjes dhe hartimit të dokumentave të “fermës” së simuluar;

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

**RM 6 Nxënësi përgatit dhe studion tregun e shitjes.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatitë mjetet dhe dokumentat e nevojshme për të përzgjedhur formën e duhur kërkimore të tregut të shitjes;
- të hartojë listën e saktë dhe të plotë të mjeteve të nevojshme që planifikohen për realizimin e studimit të tregut.
- të hartojë listën e saktë me detyrat që do të realizohen gjatë studimit të tregut të shitjes;
- të hartojë formularët dhe pyetësorët që do të përdoren për studimin e tregut të shitjes;
- të ndajë saktë detyrat dhe përcaktojë përgjegjësitë në procesin e studimit të tregut;
- të mbledhë informacione mbi tregun sipas procedurave dhe rregullave të caktuara;
- të grupojë saktë informacionet nga tregu sipas llojeve dhe kategorive të subjekteve të studiuara;
- të kryejë dhe paraqesë saktë analizën e tregut;
- të hartojë raportin e studimit të tregut sipas kriterëve të përcaktuara;
- të përcaktojë saktë cilët mund të jenë klientët potencialë, pra grupet e synuar nga ferma;
- të llogarisë saktë kostot faktike të studimit të tregut të shitjes dhe burimet e mbulimit të tyre.
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm gjatë studimit të tregut të shitjes;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë studimit të tregut të shitjes;

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

## **RM 7 Nxënësi kryen shitjet dhe regjistrimet përkatëse.**

### ***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë materialet dhe mjetet e nevojshme për kryerjen e shitjeve dhe rregjistrimeve përkatëse;
- të përgatisë saktë dokumentacionin e duhur të shitjeve si: listat e çmimeve për mallrat që do të tregtohen, materiale informuese për klientët, si dhe oferta speciale sipas udhëzimeve të dhëna;
- të shpërndajë informacionet tregtare duke përdorur mjete dhe mbartës të ndryshëm të informacionit;
- të hartojë formularë dhe pasqyra model që do të përdoren për dokumentimin dhe regjistrimin e shitjeve;
- të hartojë saktë dhe plotësojë me informacionin përkatës kartelat e klientëve;
- të hartojë kontratat e shitblerjes, mbi bazë e elementëve ligjorë;
- të përpunojë kërkesat e klientëve;
- të llogarisë saktë shpenzimet e tjera që lidhen me realizimin e procesit të shitjes;
- të hartojë saktë oferta përmbledhëse në të cilat pasqyrohen edhe kushtet e lëvrimit dhe pagesës së mallrave të shitura;
- të pranojë, kontrollojë dhe rregjistrojë saktë porositë e mbërritura nga klientët;
- të kontrollojë gjendjen e mallrave sipas cilësive dhe asortimenteve;
- të hartojë saktë njoftimet për plotësimin e gjendjeve të mallrave;
- të hartojë saktë dëftesat e lëvrimit dhe fletëdaljet e mallrave të shitur;
- të hartojë saktë dokumentat shoqërues të mallrave gjatë transportit;
- të hartojë saktë faturat e shitjes së mallrave;
- të evidentojë saktë ekzekutimin e porosive të klientëve;
- të pasqyrojë veprimet e klientëve në kartelat e tyre personale;
- të regjistrojë saktë pakësimin e gjendjes së mallrave të shitur;
- të hartojë refuzimet e shitjeve për arsye dhe në situata të ndryshme.
- të dërgojë, brenda afateve, në zyrën e kontabilitetit dokumentet e shitjes për ndjekjen e arkëtimeve.
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm gjatë shitjes dhe regjistrimeve përkatëse;
- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me shitjet dhe regjistrimet e kryera;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së

mjedisit gjatë shitjes dhe regjistrimeve përkatëse.

**Instrumentet e vlerësimit:**

- Vëzhgim me listë kontrolli.

**RM 8 Nxënësi kontabilizon shitjet.**

**Kriteret e vlerësimit:**

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatitë mjetet dhe dokumentat e nevojshme të punës për kontabilizimin e shitjeve;
- të çelë saktë ditarin analitik të shitjeve duke respektuar normativat ligjore në fuqi;
- të regjistrojë saktë faturat e shitjes në librin e shitjeve të kryera, duke respektuar normativat tatimore përkatëse;
- të kontabilizojë saktë daljen e mallrave nga magazina;
- të regjistrojë saktë faturat e emetuara në regjistrin e tyre në funksion të ndjekjes së afateve.
- të kontabilizojë saktë arkëtimin e faturave të shitjes duke kryer dhe përditësimet përkatëse në regjistrin e faturave të emetuara;
- të llogarisë të ardhurat nga shitja e mallrave dhe shërbimeve të fermës;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së kontabilizimit të shitjeve dhe hartimit të dokumentave të “fermës” së simuluar.

**Instrumentet e vlerësimit:**

- Vëzhgim me listë kontrolli.

---

**Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.**

Ky modul duhet të trajtohet në mjediset për praktikat profesionale pranë shkollës (kabineti i firmës ushtrimore) si dhe në zyrat e një ferme reale.

Për realizimin e modulit janë të domosdoshme njohuritë e mara në lëndën e “Bazat e sipërmarrjes” dhe “Drejtimi, ligjshmëria dhe ekonomia në bujqësi” lidhur me blerjen dhe shitjen e produkteve si dhe regjistrimet përkatëse.

Për kryerjen e studimit të tregut të blerjes dhe shitjes nxënësi do të përdorë një pjesë të materialeve të hartuara të përshtatshme për tregun e blerjes dhe shitjes së produkteve dhe shërbimeve.

Mësuesi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të përdorimit të dokumenteve origjinale të blerjes dhe shitjes.

Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për të kryerjen e blerjeve dhe shitjeve.

Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me proceset e punës gjatë blerjes dhe shitjes.

Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e veprimeve të blerjes dhe shitjes.

Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

---

**Kushtet e  
e domosdoshme  
për realizimin e  
modulit**

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Mjedise të praktikave profesionale në shkollë (kabineti i firmës ushtrimore).
  - Ndërmarrje bujqësore.
  - Kompiuter në lidhje me internetin.
  - Materiale të ndryshme kancelarie.
  - Formularë model të hartuar nga vetë nxënësit, të marra të gatshme në fermë si dhe të përgatitura nga mësuesi.
  - Formularë, pasqyra financiare dhe libra financiarë të detyrueshëm.
  - Lidhje telefonike, E-Mail, internet dhe fax.
  - Regjistra kontabël.
-